



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.17, datë 28 .02. 2013

PËR

**“POLITIKËN E DECENTRALIZIMIT TË DISA KOMPETENCAVE LIGJORE PRANË
ORGANEVE TË NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8, shkronja “m” të ligjit nr.8654, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”; keut II, të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.10 112, datë 09.04.2009 për “Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”; ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 për “Inspektimin e ndërtimit”; ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.777, datë 24.09.2010 për “Miratimin e rregullave për kryerjen e inspektimit, çështjet, metodologjinë, frekuencat e për mënyrën e njoftimit dhe të procedurave që ndjek administratori për zbatimin e tyre”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.313, datë 01.07.2002 për “Caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.55, datë 24.12.2012 për “Një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë së Tiranës”; venimit të Këshillit Bashkiak nr.54, datë 24.12.2012 për “Një shtesë dhe ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.8, datë 12.10.2011 për “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.53, datë 24.12.2012 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Vënien në zbatim të politikës “Një qeverisje vendore e decentralizuar”, nëpërmjet delegimit të funksioneve ligjore organeve të Njësive Bashkiake si dhe transferimit të fondeve financiare në raport të drejtë me funksionet e decentralizuara.
2. Në zbatim të pikës 1, të këtij vendimi delegohet:
 - a. Ushtrimi i pjesshëm i funksioneve të sigurimit të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike nga Njësitë Bashkiake brenda territorit përkatës.
Emërimi i punonjësve për ofrimin e këtij shërbimi bëhet nga Kryetari i Bashkisë sipas percaktimeve të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997.
 - b. Ushtrimi i pjesshëm i funksioneve të kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit për territoret respektive.

Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve për ofrimin e këtij shërbimi bëhet nga Kryetari i Bashkisë.

- c. Ushtrimi i funksioneve të kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit, sipas ligjit për bashkëpronësinë nga inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të cilët e ushtrojnë këtë funksion pranë Njësive Bashkiake përkatëse për territoret respektive.

Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve për ofrimin e këtij shërbimi bëhet nga Kryetari i Bashkisë.

3. Në zbatim të pikes 2 të këtij vendimi, pranë Njësive Bashkiake, Tiranë kryejnë funksionet e tyre sipas ligjit dhe ofrojnë shërbimin përkatës në varësi të sipërfaqes së Njësive Bashkiake; numrit të popullsisë dhe problematikave të konstatuara, përkatësisht:
- 50 punonjës të Policisë Bashkiake.
 - 50 inspektorë të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Vendor.
 - Vendimi i shtrin efektet nga data 01 Korrik 2013.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të nxjerrë aktet e nevojshme administrative, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Bashkia e Tiranës dhe Njësitë Bashkiake, për zbatim e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI